

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2401/2 Prot.

Durrës, më 21.10.2025

VENDIM

Nr. 79, datë 21.10.2025

**"Për Miratimin e Krijimit të Qendrës së Studimeve Ndërdisiplinore në Universitetin
"Aleksandër Moisiu" Durrës"**

Baza Ligjore: Neni 27, Neni 49 i Ligjit nr. 80/2015, 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.8480/1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Vendim Senati Akademik nr.111, datë 17.10.2025, Vendim Senati Akademik nr.112, datë 17.10.2025, Vendim Bordi Administrimit nr.62, datë 19.11.2024 "Për miratimin e ndryshimeve të strukturës së përgjithshme dhe organikës analitike të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës", Rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit miratuar me vendim nr. 52 datë 30.07.2021 të Bordit të Administrimit,

Rrethanat e çështjes:

1. Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.10.2025 mori në shqyrtim si pjesë e rendit të ditës propozimin e ardhur me Vendim Senati Akademik nr.111, datë 17.10.2025 "Për një ndryshim në Vendimin e Senatit Akademik nr.92, datë 18.09.2025 Për miratimin paraprak të krijimit të Qendrës së Studimeve Ndërdisiplinore në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës" dhe Vendim Senati Akademik nr.112, datë 17.10.2025 "Miratimin paraprak për një shtesë në strukturën organike të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës".

Bordi i Administrimit pas shqyrtimit të çështjes në mbledhjen e datës 21.10.2025 me votim unanim, bazuar në nenin 27 pika 1 të Ligjit nr. 80/2015, 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" *Për interesa të përbashkët studimorë, kërkimorë dhe zhvillimorë, njësitë kryesore përbërëse të një institucioni të arsimit të lartë mund të krijojnë në bashkëpunim qendra studimore ndërdisiplinore., **nenin 49 pika 1 gërma c** me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet; **neni 49 pika 1 gërma dh** miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;*

VENDOSI:

1. Miratimin e Krijimit të Qendrës së Studimeve Ndërdisiplinore e cila do të ngrihet në nivel institucional në varësi të Rektoratit.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar